



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

URDHËR

Nr. 197, datë 26 .06 .2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHME PËR PARAQITJEN DHE  
TRAJTIMIN E SHPREHJEVE TË INTERESIT, SI DHE VERIFIKIMIN E  
PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE PËR ANËTARË TË KOMISIONIT  
DISIPLINOR TË PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019 “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e rregullave për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, për anëtarët e Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë.
2. Procesi i paraqitjes, trajtimit të shprehjes së interesit, si dhe procesi i verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët, bëhet duke u bazuar në meritat e kandidatëve dhe duke respektuar parimet e përgjithshme të procedurës administrative.
3. Procedura e paraqitjes dhe e shprehjes së interesit, si dhe verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore dhe përzgjedhjes përfundimtare për anëtar të Komisionit Disiplinor të Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, sipas rregullave të këtij urdhri, bëhet për një anëtar që zgjidhet nga Ministria e Drejtësisë, për një anëtar që zgjidhet nga Shkolla e Magjistraturës dhe për një anëtar që zgjidhet nga Dhoma e Përmbarruesve Gjyqësorë Privatë, që zbatojnë kërkesat lidhur me fazat e shpalljes dhe të vlerësimit të kandidaturave sipas këtij urdhri.

4. Zgjedhja e anëtarit të Dhomës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, duhet të synojë shmangien konfliktit të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.
5. Kërkesa për shprehje interesi të kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Shkollës së Magjistraturës dhe në atë të Dhomës së Përmbauesve Gjyqësorë Privatë për kandidatin respektiv, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe qëndron e hapur për një periudhë prej 15 ditësh nga data e shpalljes.
6. Ngritja e grupeve të brendshme të punës dhe organizimi i punës, për kryerjen e procesit të vlerësimit të shprehjeve të interesit, deri në vendimmarrjen e organit/strukturës përkatëse përgjegjëse, përcaktohen në përputhje me aktet e brendshme për organizimin dhe funksionimin e institucioneve përkatëse.
7. Kandidatët e interesuar për të qenë anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë, të zgjedhur nga Ministria e Drejtësisë dhe nga Shkolla e Magjistraturës, duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e institucionit apo në rrugë elektronike pranë institucionit përkatës dokumentacionin e mëposhtëm, vërtetues të plotësisimit të kushteve ligjore:
  - a) kërkesë për shprehje interesi;
  - b) jetëshkrim;
  - c) kopje të mjetit të identifikimit;
  - ç) diplomën që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;
  - d) vërtetim nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;
  - dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;
  - e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;
  - ë) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është përmbaues në detyrë;
  - f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore.
8. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë institucioneve përkatëse të sipërcituara është 10 ditë nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 6, të këtij urdhri.
9. Në rast të mbarimit të mandatit të njërit prej anëtarëve, ndiqet e njëjta procedurë jo më vonë se 10 ditë pas marrjes dëjoni për mbarimin e mandatit nga institucioni që përcakton kandidatin që ka mbaruar mandati.

10. Procedura administrative e verifikimit të kushteve ligjore të kandidatëve fillon jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i afatit për dorëzimin e dokumentacionit dhe përfundon jo më vonë se 20 ditë nga data e nisjes së procedurës.
  11. Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative.
  12. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore, secilit kandidat i njoftohet vendimi për plotësimin ose jo të kushteve ligjore.
  13. Kandidatët e interesuar kanë të drejtën e ankimit brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit.
  14. Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet përkatësisht në faqen zyrtare të institucioneve.
  15. Vendimi për kandidatin fitues, formalizohet me aktin përkatës administrativ të ministrit të Drejtësisë, Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës apo Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
  16. Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.
  17. Në akt përcaktohet data e fillimit të mandatit dhe data e mbarimit të tij, sipas ligjit për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat.
  18. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës dhe Dhoma Kombëtare e Përmbarrimit Gjyqësor Privat.
  19. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për njoftimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI  
ETILDA GJONAJ (SALIU)

